Aplikimi për deklaratë paraprake për kryerje punimesh

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kryetari i bashkisë është përgjegjës për:

Vendimmarrjen lidhur me aplikimet që kanë si objekt kryerjen e punimeve që kryhen me deklaratë paraprake punimesh në territorin administrativ të bashkisë (sipas përcaktimeve të nenit 19, pika 4 e VKM-së nr. 408 dt. 13.05.2015).

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, reduktohen barrierat administrative dhe përmirësohen praktikat e aplikimit për lejet përkatëse.

Sporteli i shërbimit me një ndalesë për veprimtaritë ndërtimore kujdeset për të gjitha marrëdhëniet ndërmjet palës së interesuar, autoritetit vendor të planifikimit dhe organeve të tjera të administratës publike që kanë detyrimin të japin mendimin e tyre në lidhje me punimet, objekt i kërkesës për leje ndërtimi apo deklaratës për punime paraprake. Ky shërbim përbën pikën e vetme të kontaktit të palës së interesuar me administratën publike në lidhje me kërkesën për leje dhe ndërhyrjen përkatëse në territor.

Dokumentacioni i nevojshëm për deklaratë paraprake për kryerje punimesh:

Dokumentet që duhet të depozitojë personi i interesuar për njoftimin e deklaratës paraprake për kryerje punimesh, janë:

- Formulari i deklaratës (sipas VKM nr.408) dhe formatit të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve, dhe, sipas rastit:
- Dokumenti që vërteton pronësinë e tij apo të drejta të ligjshme për pasuri private ose publike, për strukturën që ka në përdorim, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- Projekti teknik i realizimit të punimeve, i firmosur nga projektues të licencuar.

Në rastin kur punimet që kryhen me deklaratë paraprake për kryerje punimesh shtrihen në territorin e më shumë se një bashkie, aplikuesi do të paraqesë dokumentacionin përkatës pranë secilës bashki, për punimet që përfshihen brenda territorit administrativ të kompetencës.

Hapat e procedurës:

- Dorëzimi i deklaratës paraprake për kryerje punimesh paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqërues të saj.
- Autoriteti vendor përgjegjës kryen verifikimet e nevojshme, brenda 5 ditëve nga data e dorëzimit të saj.
- Në rast konstatimi të mosrespektimit të kushteve dhe kërkesave ligjore që rregullojnë deklaratën paraprake të punimeve, autoriteti vendor përgjegjës e kundërshton atë me vendim të arsyetuar.
- Në mungesë të përgjigjes brenda afatit 5-ditor, konfirmimi konsiderohet i dhënë në heshtje dhe sistemi gjeneron aktin përkatës dhe njofton deklaruesin për mundësinë e fillimit të punimeve.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 5 ditëve nga kërkesa.

Aplikimi për Leje Ndërtimi për ndërtime të reja apo shtesa, me sipërfaqe të përgjithshme deri në 250 m2 pranë Njësive të Qeverisjes Vendore

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kryetari i bashkisë është përgjegjës për:

Dokumentacioni i nevojshëm:

Dokumentet që duhet të paraqesë aplikuesi për t'u pajisur me leje ndërtimi pranë njësive të qeverisjes vendore (sipas nenit 15 pika 1/3 e VKM-së nr. 408 dt. 13.05.2015 "Rregullorja e zhvillimit të territorit) janë:

- Kërkesa për leje ndërtimi, sipas formularit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve;
- Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në një
- Zhvillim, përfshirë marrëveshjet midis pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta;
- Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese;
- Projekti i ndërtimit dhe relacioni përkatës;
- Grafiku paraprak i punimeve dhe afati i dorëzimit të objekteve, sipas fazave të zbatimit;
- Preventivi;
- Deklarata e projektuesit të licencuar, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në sistemin elektronik të lejeve të ndërtimit, nëpërmjet së cilës konfirmohet përputhshmëria e projektit me lejen e zhvillimit, dokumentet e planifikimit e kontrollit të zhvillimit, në fuqi, dhe me legjislacionin që rregullon veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, përfshirë dispozitat antisizmike, të sigurisë, mbrojtjes nga zjarri dhe higjieno-sanitare;
- Lejet, licencat, autorizimet apo aktet e miratimit, të nevojshme për ushtrimin e aktivitetit, në zbatim të legjislacionit të posaçëm për lejet, licencat dhe autorizimet, në rastet kur është e nevojshme që ato të paraqiten përpara marrjes së lejes së ndërtimit;

- Mandatpagesa/t e tarifës/tarifave të aplikimit;
- Kopje e policës së sigurimit të projektuesve, për mbulimin e përgjegjësive profesionale.

Nuk janë të detyrueshme projektet e instalimeve, si dhe mbikëqyrja dhe kolaudimi i punimeve, me kushtin që zbatuesi të dorëzojë një deklaratë noteriale, me të cilën të konfirmojë, nën përgjegjësinë e tij të plotë civile dhe penale, se objekti është ndërtuar në përputhje me lejen e ndërtimit dhe projektin përkatës.

Hapat e procedurës:

Kërkesat për leje ndërtimi paraqiten për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje.
Autoriteti përgjegjës vendos brenda 10 ditëve nga data e dorëzimit të aplikimit për leje ndërtimi me procedurë të përshpejtuar (sipas përcaktimeve të nenit 24 të VKM-së nr. 408 dt. 13.05.2015 "Rregullorja e zhvillimit të territorit).

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 45 ditëve nga data e dorëzimit të aplikimit për leje ndërtimi lëshohet leja e ndërtimit.

Periudha e vlefshmërisë

Sipas afateve të përcaktuar në formularin e lejes së ndërtimit

Aplikimi për leje zhvillimi pranë Njësive të Qeverisjes Vendore

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij:

Ky shërbim përbën pikën e vetme të kontaktit të palës së interesuar me administratën publike në lidhje me kërkesën për leje dhe ndërhyrjen përkatëse në territor.

Dokumentacioni i nevojshëm:

Dokumentet që duhet të paraqesë pronari ose zhvilluesi për t'u pajisur me leje zhvillimi, janë, si më poshtë (sipas nenit 10 te VKM-së nr. 408 dt. 13.05.2015 "Rregullorja e Zhvillimit të Territorit):

- Kërkesa për leje, sipas formatit të aplikimit, të përcaktuar në këtë rregullore dhe në sistemin elektronik të lejeve;
- Dokument që vërteton të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim dhe, nëse ka, kopje të marrëveshjes për pronën;
- Mandatpagesa e tarifës së aplikimit.

Hapat e procedurës:

- Kërkesa për leje zhvillimi paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje zhvillimi.
- Autoriteti vendor përgjegjës shqyrton kërkesat për për leje zhvillimi, duke bashkërenduar punën, me të gjitha autoritetet publike të specializuara, nëse pasuria për të cilën kërkohet leja e zhvillimit ndodhet në zona apo është objekt me kufizime apo kushtëzime të veçanta sektoriale, për shkak të vlerave monumentale, arkeologjike, natyrore apo mjedisore;
- Nëse dokumentacioni është i plotë, njoftohet kërkuesi që të paguajë, të gjitha tarifat për shqyrtimin e aplikimit nga autoritetet publike që duhet të shprehen në lidhje me kërkesën, në rast se ka të tilla.
- Në rast se dokumentacioni nuk është i plotë, autoriteti përgjegjës njofton kërkuesin që, brenda të njëjtit afat, të kryejë plotësimin e dokumentacionit dhe pagesën e tarifave të shërbimit, në rast se ka të tilla.
- Me dërgimin e njoftimeve, pezullohet llogaritja e afatit të shqyrtimit të kërkesës, deri në plotësimin e dokumentacionit dhe/ose pagesës së tarifave nga kërkuesi.
- Nëse subjekti nuk plotëson dokumentacionin ose nuk paguan tarifat e shërbimit brenda afatit të caktuar, autoriteti përgjegjës merr vendim të arsyetuar për refuzimin e kërkesës për leje zhvillimi.

- Të gjitha autoritetet publike, që duhet të shprehen në lidhje me kërkesën, kanë detyrimin t'i dërgojnë autoritetit përgjegjës, nëpëmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit, të dhëna lidhur me përditësimet e infrastrukturës apo ekzistencën e kufizimeve sektoriale të mundshme, lidhur me pronën/zhvillimin e propozuar.
- Në mungesë të përgjigjes brenda afatit 10-ditor, kërkesa konsiderohet e miratuar në heshtje dhe autoriteti përgjegjës ka detyrimin të vijojë me shqyrtimin e kërkesës për leje.
- Brenda 5 ditëve, nga marrja e të gjitha përgjigjeve prej autoriteteve publike të specializuara apo miratimit në heshtje, nga ana e tyre, Autoriteti vendor përgjegjës, merr vendimin për:
  a) lëshimin e lejes së zhvillimit;
  b) refuzimin e lejes së zhvillimit;

  dhe shprehet nëse projekt-ideja është hartuar në përputhje me dokumentet e planifikimit dhe rregullat e projektimit dhe, nëse është rasti, jep vërejtjet e veta.

Leja e zhvillimit apo vendimi për refuzimin e saj i dërgohet kërkuesit nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

10 ditë nga paraqitja e kërkesës për të lëshuar lejen e zhvillimit.

Aplikimi për t'u pajisur me certifikatë përdorimi

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe në mbështetje të VKM-së nr. 725, dt. 2.9.2015 "Për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit", që prej muajit nëntor 2015 ka filluar punën Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) si një institucion publik qendror në varësi të ministrit përgjegjës për Zhvillimin Urban. Ajo kryen funksionet e Sekretariatit Teknik pranë Këshillit Kombëtar të Territorit.

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, reduktohen pengesat administrative dhe përmirësohen praktika e aplikimit për lejet përkatëse.

Sporteli i shërbimit me një ndalesë për veprimtaritë ndërtimore kujdeset për të gjitha marrëdhëniet ndërmjet palës së interesuar, Autoritetit të Zhvillimit te Territorit dhe organeve të tjera të administratës publike që kanë detyrimin të japin mendimin e tyre në lidhje me punimet, objekt i kërkesës për leje ndërtimi apo deklaratës për punime paraprake. Ky shërbim përbën pikën e vetme të kontaktit të palës së interesuar me administratën publike në lidhje me kërkesën për leje dhe ndërhyrjen përkatëse në territor. Në përfundim të procesit të zhvillimit aplikuesi paraqet kërkesën për t'u pajisur me certifikatë përdorimi.

Dokumentacioni i nevojshëm:

Subjekti aplikues i cili kërkon të pajiset me certifikatë përdorimi, duhet të depozitojë:

- Kërkesën për pajisjen me certifikatë përdorimi, drejtuar pranë Autoritetit të Zhvillimit të Territorit;
- Procesverbalin/aktin e kolaudimit të hartuar nga kolaudatori i licencuar, së bashku me licencën përkatëse, e cila duhet të jetë brenda afatit të vlefshmërisë.
- Deklaratën e përputhshmërisë të lëshuar nga subjekti ndërtues që ka kryer punimet, në të cilën konfirmohet kryerja e punimeve në përputhje me normat dhe standardet e sigurisë në fuqi.
- Dokumentacionin shoqërues, i cili përfshin:
  - Aktet e kontrollit për proceset e ndërtimit

Hapat e procedurës:

- Autoriteti përgjegjës, brenda 3 ditëve nga depozitimi i deklaratës së përputhshmërisë, kërkon, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, të gjitha opinionet, relacionet dhe aktet e konfirmimit, që janë të nevojshme për lëshimin e certifikatës së përdorimit të objektit.
- Autoritetet publike të specializuara që duhet të shprehen në lidhje kryerjen e punimeve, kanë detyrimin t'i njoftojnë autoritetit përgjegjës, nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, opinionet, relacionet dhe aktet e konfirmimit. Në mungesë të përgjigjes, brenda afatit 15-ditor, nga momenti i marrjes së kërkesës, pëlqimi apo miratimi konsiderohet i dhënë dhe autoriteti përgjegjës ka detyrimin të vijojë me procedurat përkatëse.
- Brenda 5 ditëve, nga marrja e të gjitha përgjigjeve prej autoriteteve publike të specializuara apo miratimit në heshtje nga ana e tyre, sipas rastit, zyra/organi përgjegjës i planifikimit, pranë autoritetit vendor, apo Sekretariati i KKT-së, përgatit raportin e vlerësimit dhe e njofton atë nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve.

- Brenda 7 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit, dhe, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e paraqitjes së deklaratës së përputhshmërisë, sipas rastit, kryetari i bashkisë apo Sekretariati i KKT-së vendos:
  a) lëshimin e certifikatës së përdorimit të objektit, që vërteton përfundimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes së ndërtimit ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, si dhe zbatimin e kritereve të dokumenteve të planifikimit dhe të kontrollit të zhvillimit;
  b) në rastet kur konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera, për lëshimin e aktit të konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor, dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi.
- Në rastin kur autoriteti përgjegjës, brenda afatit te përcaktuar, nuk lëshon certifikatën e përdorimit dhe aktet e kontrollit janë pa shkelje dhe është lëshuar akti i kolaudimit pa shkelje, atëherë kërkesa, konsiderohet, automatikisht, e miratuar në heshtje dhe sistemi elektronik i lejeve të ndërtimit gjeneron, menjëherë, vendimin e miratimit.
- Vendimi i miratimit në heshtje publikohet automatikisht nga sistemi elektronik i lejeve edhe në regjistër. Vendimi i miratimit në heshtje, sipas kërkesës së paraqitur, përbën të vetmin dokument të nevojshëm, së bashku me aktet e kolaudimit, për regjistrimin e pronës në regjistrat e pasurisë, sipas legjislacionit në fuqi.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 7 ditëve nga paraqitja e raportit të vlerësimit e jo më shume se 30 ditë nga data e deklaratës së përputhshmërisë.

Aplikimi për leje ndërtimi për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve pranë Njësive të Qeverisjes Vendore

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kryetari i bashkisë është përgjegjës për:

Vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve të njësive individuale.

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, reduktohen barrierat administrative dhe përmirësohen praktikat e aplikimit për lejet përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm i aplikimit për leje ndërtimi për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve pranë Njësive të Qeverisjes Vendore:

Dokumentet tekniko-ligjore të nevojshme për të aplikuar për lejen për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve pranë autoritetit përgjegjës së njësisë së qeverisjes vendore (sipas përcaktimeve të nenit 12 të VKM-së 408 dt. 13.05.2015) janë:

- Kërkesa për leje për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve të njësisë individuale.
- Dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim, përfshirë marrëveshjet nëpërmjet pronarëve dhe zhvilluesit ose/dhe palëve të treta.
- Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese.

Hapat e procedurës:

- Kërkesa për leje për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve të njësisë individuale paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje.
- Autoriteti përgjegjës shqyrton kërkesat për leje për ndryshimin e aktiviteteve ose funksioneve, brenda 10 ditëve nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mangësie në dokumentacion, njoftohet aplikuesi që, brenda të njëjtit afat, të kryejë plotësimin e dokumentacionit.
- Kryetari i bashkisë, brenda 10 ditëve nga data e dorëzimit të aplikimit vendos, në bazë të përputhshmërisë me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit të tokës të përcaktuara nga PPV-ja (Planet e Përgjithshme Vendore) ose PDV-ja (Planet e Detajuara Vendore), ose në përputhje me kategoritë dhe nënkategoritë e përdorimit ekzistues të tokës kur nuk ka PPV ose PDV, për:
  - miratimin e lejes për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve të njësisë individuale
  - refuzimin e lejes për ndryshimin e aktiviteteve dhe/ose funksioneve të njësisë individuale
- Vendimi njoftohet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit dhe botohet në regjistër, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 10 ditëve nga kërkesa për leje me kusht mosndryshimin e sistemit konstruktiv.

Aplikimi për leje ndërtimi për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kryetari i bashkisë është përgjegjës për:

Vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit për leje ndërtimi të miratuara nga autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit të njësisë së qeverisjes vendore.

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, reduktohen barrierat administrative dhe përmirësohen praktikat e aplikimit për lejet përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm për leje ndërtimi për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore:

Dokumentet tekniko-ligjore të nevojshme për të aplikuar për lejen e ndërtimit pranë autoritetit përgjegjës (sipas përcaktimeve të nenit 40 të ligjit nr. 107/2014) janë:

- Kërkesë e subjektit të pajisur me leje ndërtimi, përmes sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit;
- Marrëveshja midis palëve që vërtetojnë kalimin e titullit mbi lejen e ndërtimit;
- NIPT-i i subjektit që i transferohet leja e ndërtimit;
- Licencat e subjektit që i transferohet leja e ndërtimit.

Hapat e procedurës:

- Kërkesa për leje për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit, bëhet me kërkesë të subjektit të pajisur me leje ndërtimi. Kërkesa paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje ndërtimi.
- Autoriteti përgjegjës shqyrton kërkesat për leje për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit, brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mangësie në dokumentacion, njoftohet aplikuesi të kryejë plotësimin e dokumentacionit.
- Kryetari i bashkisë vendos për:
  - miratimin e lejes për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit
  - refuzimin e lejes për ndryshimin e subjektit të lejes së ndërtimit
- Vendimi njoftohet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit dhe botohet në regjistër, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 30 ditëve nga kërkesa për leje.

Aplikimi për leje ndërtimi për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, :

Dokumentacioni i nevojshëm për leje ndërtimi për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore:

Dokumentet tekniko-ligjore të nevojshme për të aplikuar për leje për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit pranë AZHT (sipas përcaktimeve të nenit 40 të ligjit nr. 107/2014 dhe nenit 18 të VKM-së 408 dt. 13.05.2015) janë:

- Kërkesa për shtyrjen e afatit e cila parashtron arsyet për të cilat nuk ka qenë i mundur përfundimi i punimeve brenda afatit;
- Kalendari i ri i punimeve;
- Vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit.

Hapat e procedurës:

- Kërkesa për leje për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit, me kërkesë të subjektit të pajisur me leje ndërtimi, bëhet vetëm një herë dhe jo më vonë se 45 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes së ndërtimit. Kërkesa paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje ndërtimi.
- Autoriteti përgjegjës shqyrton kërkesat për leje për shtyrje afati të lejes së ndërtimit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mangësie në dokumentacion, njoftohet aplikuesi të kryejë plotësimin e dokumentacionit.
- Kryetari i bashkisë vendos për:
  - miratimin e lejes për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit
  - refuzimin e lejes për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit
- Vendimi njoftohet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit dhe botohet në regjistër, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 30 ditëve nga kërkesa për leje.

Aplikimi për leje ndërtimi për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore

Në bazë të Ligjit nr. 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, kryetari i bashkisë është përgjegjës për:

Vendimmarrjen lidhur me aplikimet për leje për shtyrje afati të lejes së ndërtimit për leje ndërtimi të miratuara nga autoriteti përgjegjës i zhvillimit të territorit i njësisë së qeverisjes vendore.

Me shërbimin me një ndalesë dhe procedura të thjeshtuara, transparente dhe të shpejta, reduktohen barrierat administrative dhe përmirësohen praktikat e aplikimit për lejet përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm për leje ndërtimi për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit pranë Njësive të Qeverisjes Vendore:

Dokumentet tekniko-ligjore të nevojshme për të aplikuar për leje për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit pranë AZHT (sipas përcaktimeve të nenit 40 të ligjit nr. 107/2014 dhe nenit 18 të VKM-së 408 dt. 13.05.2015) janë:

- Kërkesa për shtyrjen e afatit e cila parashtron arsyet për të cilat nuk ka qenë i mundur përfundimi i punimeve brenda afatit;
- Kalendari i ri i punimeve;
- Vërtetimi i pagesës së gjobës për shkeljen e afatit.

Hapat e procedurës:

- Kërkesa për leje për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit, me kërkesë të subjektit të pajisur me leje ndërtimi, bëhet vetëm një herë dhe jo më vonë se 45 ditë përpara përfundimit të afatit të lejes së ndërtimit. Kërkesa paraqitet për shqyrtim nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve, i cili mundëson edhe ngarkimin, lehtësisht, të dokumentacionit shoqërues të kërkesës për leje ndërtimi.
- Autoriteti përgjegjës shqyrton kërkesat për leje për shtyrje afati të lejes së ndërtimit brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së tyre. Në rast mangësie në dokumentacion, njoftohet aplikuesi të kryejë plotësimin e dokumentacionit.
- Kryetari i bashkisë vendos për:
  - miratimin e lejes për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit
  - refuzimin e lejes për shtyrje të afatit të lejes së ndërtimit
- Vendimi njoftohet nëpërmjet sistemit elektronik të lejeve të ndërtimit dhe botohet në regjistër, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së vendimit.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Brenda 30 ditëve nga kërkesa për leje.